

RAPORT STUDIMOR

INFORMIMI, NJOFTIMI DHE KONSULTIMI PUBLIK NGA PUSHTETI VENDOR

BASHKIA PUKË



LËVIZJA RINORE PËR DEMOKRACI
QERSHOR 2022

Tabela e përmbajtjes

1. HYRJE	2
2. LISTA E SHKURTIMEVE.....	4
3. PROFILI I BASHKISË PUKË	5
4. METODOLOGJIA	7
5. ANALIZË E FORMAVE TË NJOFTIMIT, INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK.....	8
6. GJETJET NGA ANKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E BASHKISË PUKË	8
KONKLUZIONE	24
REKOMANDIME.....	25

1. HYRJE

Raporti studimor “Informimi, Njoftimi dhe Konsultimi Publik nga pushteti vendor” kryhet në kuadër të projektit “Përballja e Ofertave Politike – POP”. Ajo është një nismë e rrjetit të 12 organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga Olof Palme International Centre në kuadër të një programi të financuar nga Suedia: “Shoqëria Civile, Pjesëmarrja Qytetare, Llogaridhënia dhe Ndryshimi Social” dhe nga National Endowment for Democracy.

Gjatë vitit 2019 janë hartuar kontratat sociale për 9 bashki (Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Kamëz, Pogradec dhe Pukë) dhe që prej atij viti rrjeti “Përballja e Ofertave Politike” monitoron zbatimin e tyre përmes dy projekteve që shkrihen te njëri – tjetri të financuara nga Olof Plame International Centre (OPIC) dhe National Endowment for Democracy (NED).

Në vitin 2021, Rrjeti POP u zgjerua duke shtuar edhe bashkitë Elbasan, Vau i Dejës dhe Korçë. Tre Kontrata Sociale u nënshkruan në bashkitë e mësipërme duke vijuar kështu monitorimin për zbatimin e tyre në 12 bashki. Nëpërmjet këtij projekti Rrjeti POP, synon të forcojë bashkëpunimin me qytetarët në përfshirjen e tyre në vendimmarrje në nivel vendor, duke qenë një urë lidhëse mes tyre (qytetarëve) dhe pushtetit vendor për sa i përket transparencës, llogaridhënies dhe demokracisë vendore.

Organizatat e Rrjetit POP gjatë periudhës maj -qershor 2022 realizuan pyetësorë me stafet përkatëse ne Bashki dhe me përfaqësues të Këshillave Bashkiakë dhe përgjigjet e marra nga pyetësorët u përballën me analizën e bërë nga vetë shoqatat sa i përket gjendjes aktuale në secilën bashki në lidhje me menyrën se si realizohet dhe mjetet e format që bashkitë përdorin për njoftimin, informimin dhe konsultimin e publikut.

Kjo analizë tregoi që bashkitë i vlerësojnë këto procese dhe përpiqen të përdorin mjete dhe forma të ndryshme për të patur qytetarët dhe qytetaret pjesë të veprimtarisë dhe vendimmarrjes së tyre por ka dhe sfida që duhen tejkaluar e mangësi të cilat duhen përmirësuar.

Për shembull faqet zyrtare të bashkive duhen të jenë më miqësore për publikun, regjistri i kërkesë ankesave duhet të përditësohet vazhdimisht, programet e transparencës duhet të jenë lehtësisht të aksesueshme dhe të konsultohen me qytetarët, bashkitë duhet të përdorin një numër të konsiderueshëm mjesh dhe formash për njoftimin dhe informimin e qytetarëve. Proceset e konsultimeve realizohen në bashkitë pjesëmarrëse por më shumë duhet te punohet për rritjen dhe nxitjen e interesit të qytetarëve për të marrë pjesë dhe për t’u përfshirë në sa më shumë takime e dëgjesa publike, përfshirë procesin e hartimit të projekt-buxheteve.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët, si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve rrjeti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Është një përpjekje për të rritur hapësirat për debate publike dhe informacione të qytetarëve në lidhje me platformat e politikave nga njëra anë dhe duke i orientuar këto platforma drejt nevojave dhe përparësive të komunitetit nga ana tjetër.

Organizatat partnere të rrjetit janë: Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim” Tiranë; Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës; Qendra Rinore Vlorë; Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz; Epoka e Re, Fier; Intelektualët e Rinj Shpresë, Shkodër; Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë; Qendra Rinore për Progres, Kukës, Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec, Gruaja në Zhvillim Korçë; Tjetër Vizion Elbasan dhe Qendra “Hapa të Lehtë” Vau i Dejës.

2. LISTA E SHKURTIMEVE

BP	Buxhetimi me Pjesëmarrje
BPGJ	Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinnor
KB	Këshilli Bashkiak
KKQV	Komisione Këshillimore Qytetare Vendore
GADC	Gender Alliance Development Center
GMS	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NED	National Endowment for Democracy
NJVQV	Njësi e Vetëqeverisjes Vendore
OPIC	Olof Palme International Centre
OSHC	Organizatë e Shoqërisë Civile
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PT	Programi i Transparencës
QV	Qeverisje Vendore
RAT	Reforma Administrativo-Territoriale

3. PROFILI I BASHKISË PUKË

Zona Gjeografike: Puka kufizohet në veri dhe në perëndim me Bashkinë e Vaut të Dejës, në lindje me Bashkinë Fushë Arrëz dhe në jug me Bashkitë Mirditë dhe Lezhë. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Pukës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Bashkia e Pukës ka 11,069 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil kjo bashki numëron 16,836 banorë. Ajo ka një sipërfaqe prej 505.53 km² me një densitet prej 33.30 banorë/km² sipas Regjistrimit Civil dhe 21.89 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Të dhëna të tjera: Bashkia e Pukës është një ndër zonat e pasura minerare të vendit, e cila disponon gjithashtu një sipërfaqe të konsiderueshme pyjore. Megjithatë, prerja pa kriter e pyjeve ka shkaktuar jo pak probleme për këtë zonë.

Mbyllja e minierave apo dhënia e tyre me koncesion ka shtuar numrin e të papunëve në Pukë, duke e kthyer varfërinë në një problem akut për banorët e zonës. Për shkak të saj, një pjesë e mirë e popullatës ka migruar në drejtim të Shqipërisë së Mesme ose emigruar jashtë Shqipërisë. Të ardhurat nga emigracioni janë një burim i rëndësishëm mbijetese për këtë bashki. Prej vitesh në këtë zonë kanë munguar investimet me rëndësi, ndërsa rruga Durrës-Pukë e ka aneksuar dhe izoluar edhe më shumë Bashkinë e Pukës.

Terreni malor i Pukës është shumë i përshtatshëm për zhvillimin e turizmit malor; krahas pasurive dhe burimeve natyrore me vlera të mëdha ekonomike që gjenden brenda hapësirës gjeografike të Pukës, kryesisht pyje natyrore, bimë mjekësore, pasuri nëntokësore minerare. Gjatë viteve të fundit, një numër i vogël turistësh janë rikthyer në Pukë për shkak të hapjes së një piste skish dhe ndërtimit të disa haneve. Megjithatë, numri i tyre vazhdon të mbetet i ulët.

Prej vitesh në këtë zonë kanë munguar investimet me rëndësi, ndërsa rruga Durrës-Pukë e ka aneksuar dhe izoluar edhe më shumë Bashkinë e Pukës. Problem për Bashkinë e Pukës vijon të mbetet stina e dimrit, ku bllokimi i rrugëve nga dëbora izolon një pjesë të mirë të zonës dhe vështirëson edhe më shumë jetesën e banorëve. Përmirësimi i infrastrukturës rrugore konsiderohet një ndër sfidat kryesore për Bashkinë e re të Pukës. Rrugët dytësore që lidhin fshatrat e Gjegjanit, Qelëz dhe Luf-Qerretit me qytetin e Pukës dhe dërgimi i shërbimit shëndetësor në këto fshatra ndikojnë drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së banorëve.

Profili ekonomik

Ekonomia e bashkisë Pukë është e zhvilluar në disa drejtime si: bujqësia, blegtoria, burimet ujore, burimet nëntoksore mineralet, kohët e fundit turizmi dhe turizmi familjar, bujtinat, agroturizmi, frutat e pyllit, kërpudhat, bletaria, dhe punët sezonale.

Problemet kryesore po shfaqen me largimin e popullsisë kryesisht të rinjtë duke ndikuar negativisht në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të zonës e të gjithë sektorëve të përmendur më lart.

Gjatë viteve të fundit, një numër i vogël turistësh janë rikthyer në Pukë për shkak të hapjes së një piste skish dhe ndërtimit të disa haneve. Megjithatë, numri i tyre vazhdon të mbetet i ulët. Për zhvillimin e turizmit në zonën e Pukës nevojitet promovimi i turizmit familjar në gamën e mundësive të zhvillimit ekonomik.

Përpunimi i drurit shihet si një aktivitet me rëndësi për gjallërimin ekonomik të zonës, por ky aktivitet duhet shoqëruar me kritere të rrepta në shfrytëzimin e fondeve pyjore. Paralelisht me këtë aktivitet, mbështetja e bujqësisë dhe e blegtorisë konsiderohet e domosdoshme për zonën e Pukës.

Mbështetja e biznesit fason për hapjen e fabrikave në këtë bashki mendohet si një mundësi e mirë për punësimin e grave dhe vajzave si dhe për gjenerimin e të ardhurave. Nxitja e aktiviteteve të vogla ekonomike në Bashkinë e Pukës do të ishte më e dobishme nëse fokusohet në traditat ekzistuese artizanale dhe prodhimin e bimëve mjekësore apo produktet e drurit.

Qeverisja vendore

Bashkia e Pukës është pjesë e Qarkut Shkoder dhe përbëhet nga 4 njësi administrative Rrape, Gjegan, Luf-Qerret dhe Qelëz, Qelza është e përcaktuar edhe si një nga 100 fshatrat turistik të Shqipërisë. Këshilli Bashkiak përbëhet nga 15 këshilltarë, përfaqësues të majtë politik të zgjedhur në zgjedhjet vendore të vitit 2019.

4. METODOLOGJIA

Për hartimin e raportit mbi situatën e informimit, njoftimit dhe konsultimit publik në Bashkinë Pukë janë kërkuar dhe përdorur një seri teknikash dhe instrumentash, të tilla si: a) hartimi i metodologjisë dhe instrumentit të anketimit (dy pyetësorë); b) kërkim dhe analizim të informacionit, dokumentave (fizikë dhe elektronikë) dhe kuadrit rregullator e ligjor përkatës; c) intervista të thelluara me stafin e bashkisë dhe anëtarë të Këshillit Bashkiak; d) analizim dhe përpunim të të dhënave të anketimit dhe e) përgatitja e raportit së bashku me rekomandimet përkatëse.

Ekspertët e projektit e bazuan procesin e kërkimit dhe analizimit në tërësinë e informacionit dokumentacionit dhe praktikave, të përdorura në procese të ndryshme të njoftimit, informimit, konsultimit dhe angazhimit të komunitetit në bashkëqeverisje dhe vendimarrje. Procesi i kërkimit dhe analizimit u shtri si në dokumencionin ekzistues zyrtar, ashtu edhe në kuadrin respektiv rregullator e ligjor, të tilla si Ligji Nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligji Nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, etj. Identifikimi dhe analiza e burimeve ekzistuese tregoi se ka pak informacion dhe të dhëna të disonueshme mbi praktikën e përfshirjes qytetare në qeverisjen vendore.

Pamjaftueshmëria e informacionit të disponueshëm mbi çështjen në fjalë, theksoi rëndësinë e procesit të anketimit me të gjithë hallkat e veta (hartimi i metodologjisë, përcaktimi i rubrikave dhe informacionit që duhej mbledhur dhe analizuar, dhe format e mjetet që do të përdorehin për kryerjen e tij). Metoda kryesore për realizimin e studimit është ajo sasiore, që nënkupton përdorimin e pyetësorëve për mbledhjen e të dhënave. Anketimi përdori gjerësisht elemente të vlerësimit cilësor nëpërmjet pyetjeve të hapura dhe shpjeguese me qëllim eksplorimin e instrumenteve dhe proceseve që sigurojnë angazhim dhe gjithë përfshirje të komuniteteve në pushtetin vendor. Metodologjia e studimit mbart elementë të fortë të vlerësimit informativ.

Pjesë e këtij anketimit janë drejtues, stafe teknike dhe këshilltarë vendorë të 12 bashkive të madhësive të ndryshme të përfshira në programet shumë vjeçare që Olof Palme ka zbatuar në vend. Për anketimin u hartuan dy pyetësorë me pyetje shteruese cilësore dhe sasiore, të cilat mbulojnë një gamë të gjerë temash dhe çështjesh. Për përgatitjen e pyetësorëve u konsultuan paraprakisht ligjet, rregulloret dhe udhëzimet përkatëse që përbëjnë kuadrin ligjor dhe institucional mbi informimin, njoftimin dhe konsultimin qytetar në nivel vendor.

Faza përmbyllëse përfshiu hedhjen, përpunimin statistikor, studimin dhe analizimin e të dhënave, si dhe përgatitjen e këtij raportit përfundimtar.

5. ANALIZË E FORMAVE TË NJOFTIMIT, INFORMIMIT DHE KONSULTIMIT PUBLIK

Komunikimi i vazhdueshëm në institucionet publike është një ndër elementët kryesorë për të krijuar një marrëdhënie të mirë mes institucionit dhe publikut. Institucione të ndryshme përdorin mënyra të ndryshme për të komunikuar me publikun qoftë në funksion të promovimit të aktiviteteve të tyre apo në funksion të përmbushjes për të drejtën për informim.

Ndër elementët kryesorë për të mbajtur një publik të informuar janë edhe mediat e ndryshme të cilat ndiqen nga qytetarët. Përdorimi i teknologjive të reja dhe mediave sociale ka shtuar ndjeshëm nivelin e komunikimit midis institucioneve dhe publikut, aktorëve politikë e publikë me publikun dhe anasjelltas.

Faqja Ëeb e Bashkisë Pukë

Bashkia Pukë përdor faqen zyrtare në ëeb <https://bashkiapuke.gov.al/> Kjo faqe në ëeb është e ndërtuar më shumë mbi bazën e dhënies së informacionit në formën e shkruar dhe shikohet si një nga mënyrat me të cilat Bashkia komunikon me qytetarët. Pamja e parë që shfaqet sapo hapim faqen janë foto dhe informacione të qytetit dhe një menu ku mund të klikojmë për të marrë informacione të ndryshme për: Bashkinë, Këshillin Bashkiak, Programin e Transparencës, shpallje apo njoftime, informacione të ndryshme, për turizmin, për qytetarët. Në këto momente është i hapur dhe një sondazh për qytetarët ku pyeten “Ku mendoni që duhet të shkojnë më shume investimet e Bashkisë Pukë” në turizëm, bujqësi, infrastrukturë etj. Gjatë përgatitjes së raportit kemi vërejtur se informacionet janë të përditësuara, faqja është lehtësisht e aksesueshme, gjithashtu bashkia përdor faqen e Facebook për shpërndarje të informacionit. Edhe Këshilli i bashkisë ka faqen e tij të Facebook por nuk është aktive njëjtë si faqja e Bashkisë.

Në vitin e kaluar është vënë në funksion edhe zyra me një ndalesë e cila ju vjen në ndihmë qytetarëve me kërkesat apo informacionet e duhura.

6. GJETJET NGA ANKETIMI ME PËRFAQËSUESIT E BASHKISË PUKË

Kuadri ligjor në fuqi parashikon një sërë detyrimesh dhe përgjegjësisht në lidhje me format dhe mjetet që institucionet publike duhet të vënë në dispozicion të pjesëmarrjes së


publikut dhe grupeve të interesit në procesin e informimit, njoftimit dhe përfshirjes së tyre në konsultim e vendimarrje.

Për të parë ecurinë e këtyre proceseve në respekt edhe detyrim të ligjit dhe qytetarëve, u zhvillua një anketim me 13 përfaqësues të Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Pukë. Anketimi synon të evidentojë dhe sjellë në vëmendje situatën aktuale të pjesëmarrjes qytetare në proceset konsultuese dhe vendimmarrëse si dhe të analizojë të gjitha format dhe instrumentat që institucioni i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak përdorin për sjelljen më pranë të qytetarëve në bashkëqeverisje.

Shtatë të intervistuarit nga institucioni janë drejtues të sektorëve kryesorë të Bashkisë, të tillë si: sektori i emergjencave civile; sektori i shërbimeve komunitare, utilitare dhe administrative; sektori i ndihmës ekonomike; sektori i administrimit të përgjithshëm; sektori juridik dhe prokurimit publik; sektori i njësisë së integritetit dhe burimet njerëzore.


Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi Publik në Nivel Vendor

Në zbatim të detyrimeve të parashikuara në ligjin 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”. Në Bashkinë Pukë të anketuarit janë pyetur mbi rëndësinë e njoftimit në vendimarrjen vendore, duke e cilësuar të gjithë si një proces *shumë të rëndësishëm*.



Rëndësia e informimit në vendimarrjen vendore për të gjithë punonjësitë e bashkisë vlerësohet si një proces *shumë i rëndësishëm*. E drejta për informim është e garantuar në përputhje me ligjin 119/2014, ku secili mund të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, insitucionet publike duhet të garantojnë transparencën dhe të drejtën e informimit për të gjithë.

Pyetja 1.2 Në opinionin tuaj si drejtues/nëpunës, sa i rëndësishëm është konsultimi në vendimarrjen vendore?
7 responses




Pjesëmarrja e publikut në vendimarrje është një e drejtë e qytetarëve në kuadër të qeverisjes, po ashtu përbën edhe një detyrim qytetar për të kontribuar në drejtim të një qeverisjeje të mirë. Ligji 146/2014 “Për njoftimin dhe Konsultimin publik” si dhe ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”,


mbështesin dhe nxisin pjesëmarrjen efektive gjithëpërfshirëse të komunitetit në qeverisjen vendore. Të anketuarit e vlerësojnë si një proces shumë të rëndësishëm konsultimin me publikun, po ashtu nga monitorimi Bashkia Pukë e ka realizuar këtë proces kryesisht konsultimi për taksat dhe tarifat. Për të pasur një proces efektiv konsultimi publik duhet të përmbushen tre komponentët kryesorë të tij: njoftimi, konsultimi dhe pjesëmarrja.

Kuadri ligjor për njoftimin, informimin dhe konsultimin në nivel vendor

Pyetja 2. A e njihni bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimarrjen vendore?
7 responses




Pyetja 3. Cili është vlerësimi juaj për kuadrin ligjor mbi njoftimin dhe informimin e publikut në nivel vendor? (mund të zgjidhni më shumë se sa një alternativë)
7 responses



Në lidhje me njohurinë mbi bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimarrjen vendore, duket se punonjësit e Bashkisë zotërojnë informacionin e duhur për të luajtur rolin e tyre. Bazuar në gjetjet e anketës, 3 të intervistuar u përgjigjen shumë mirë, ndërsa 4 e të intervistuarve janë përgjigjur se e njohin mirë. Ndërsa, mbi vlerësimin e kuadrit ligjor 5 nga të intervistuarit janë shprehur se është i qartë dhe i plotë, 2 janë shprehur se është i qartë por jo i plotë. Pyetjes nëse mendoni që ka nevojë për rishikim apo plotësime, cilat do të ishin rekomandimet tuaja të anketuarit janë përgjigjur se duhet të jetë më i aksesueshëm për njerëzit, më i zgjeruar dhe më i detajuar për pushtetin vendor duke u shoqëruar edhe me rekomandime dhe manuale zbatimi.

Koordinatori për Konsultimin Publik dhe Transparencën

Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik parashikohet Ligji 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik”, Ligji 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” dhe VKM Nr. 828, datë 7.10.2015, “Për Miratimin e Rregullave të Krijimit dhe Administrimit të Regjistrat Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet Publike. Koordinatori për Njoftimin dhe Konsultimin Publik sipas ligjit ka një rol të rëndësishëm, në procesin realizimit të njoftimeve dhe konsultimeve publike dhe me detyra të përcaktuara qartë. Të intervistuarit në bashki janë përgjigjur 6 për ekzistencën e koordinatorit për konsultim publik dhe 1 është përgjigjur që jo, njëjtë janë përgjigjur edhe për transparencën.



Të dhënat e koordinatorit duhet të afishohen publikisht, në faqen zyrtare të bashkisë. Nga monitorimet e kryera në faqen zyrtare ëeb të Bashkisë Pukë të dhënat dhe kompetencat e koordinatorit për njoftimin dhe konsultimin publik janë të publikuara.



Emër, mbiemër: Armir Mehaj
E-mail: info@bashkiapuke.gov.al / mehaj_armir@hotmail.com
Adresa: Bashkia Pukë, Sheshi "Gjergj Kastrioti (Skënderbeu)"
Orari: E hënë – e premte, 08:00 – 16:00

SHKRUAJI KRYETARIT

TE DHENAT ADMINISTRATIVE

HARTA TERRITORIALE

Kompetencat

1. I mundëson çdo kërkuar të drejtën për t'u njohur me informacionin publik, duke u konsultuar me dokumentin original ose duke marrë një kopje të tij; b) krijon, mban, publikon dhe përditëson regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve;
2. Bashkërendon punën për plotësimin e kërkesave për informacione brenda afateve;
3. Regjistron kërkesat për informacion dhe cakton një numër rendor për secilën prej tyre;
4. Dërgon kërkesën për informim te një autoritet tjetër publik, brenda afateve të parashikuara në këtë ligj, kur rezultoni se autoriteti publik ku është depozituar kërkesa


Buxheti

Koordinatori, informacionet e kërkuara dhe shërbimet e ofruara

- BUXHETI DHE TAKSAT
- URBANISTIKA, PLANI VENDOR
- SHERBIMET PUBLIKE
- KONSULTIME PUBLIKE
- KENDI I BE
- TURIZMI
- KERKESA, ANKESA, FORMULARE
- HELPDESK

Instrumentat për Njoftimin e Qytetarëve

Për njoftimin e qytetarëve në lidhje me çështje të ndryshme Bashkia Pukë duket se përdor një tërësi formash në mënyrë që informacioni të shkojë tek çdo target grup. Format e ndarjes së informacionit me qytetarët realizohen nëpërmjet: lajmërimeve publike të afishuara në ambientet e Bashkisë, lajmërim në mediat audio-vizive, lajmërim në mediat sociale (Facebook) etj. Vihet re se lajmërimet individuale nëpërmjet postës dhe postës elektronike kryhen për çështje apo njoftime specifike për persona të caktuar dhe përdoren në raste të caktuara dhe ëeb, dëgjesa publike, sondazhe, etj.




Rezultatet e anketimit për këtë pyetje janë si më poshtë:


- Njoftimi me mediat sociale 100%
- Njoftim në këndet e Bashkisë 85.7%
- Lajmërim në mediat audio-vizive 42.9%
- Lajmërim individual përmes postës dhe postës elektronike 28.6%

Pyetjes sa njoftime të publikuara në tabelat e lajmërimeve dhe online janë bërë gjatë vitit 2021, të gjithë të intervistuarit u shprehën se nuk kanë informacion për një numër të saktë por janë të publikuara në faqen ëeb të Bashkisë.

Regjistri Elektronik



Nga monitorimet Regjistri Elektronik është i publikuar në faqen ëeb të Bashkisë. Ai ndahet në regjistrin për ankesa, kërkesa dhe vërejtje, regjistri i projekt-akteve për konsultim publik të KB, regjistri publik për transparencën e mbledhjeve të KB, si dhe regjistri i peticioneve e iniciativave qytetare. Nga anketimet e kryera, rreth 71.4% janë në dijeni të ekzistencës së Regjistrit Elektronik dhe publikimit të tij online, ndërsa 1 i intervistuar është përgjigjur nuk ka një regjistër dhe 1 është përgjigjur që nuk ka dijeni. Po ashtu nga vëzhgimet e kryera ky regjistër ekziston në faqen e Bashkisë, por për vitin 2021 nuk është regjistruar asnjë ankesë apo kërkesë.




Ndërsa të intervistuarit janë shprehur se është përgjegjës për përditësimin e regjistrimit elektronik personi përgjegjës i IT, por dhe secili sektor i administratës së bashkisë.

Instrumentat për Informimit e Qytetarëve

Sa i përket mjeteve që përdor Bashkia Pukë për informimin e qytetarëve, të anketuarit pohojnë se më tepër përdorin zyrat me një ndalesë, këndet e informimit në ambientet e institucionit, faqen zyrtare të Bashkisë, si dhe mediat sociale pasi 100% e të intervistuarve i shohin si këto si mjete të rëndësishme për informimin e qytetarëve.

Më pas si format më të përdorura për informimin e qytetarëve renditin bashkëpunimin me mediat lokale për ndarje informacionesh duke i parë ato si një nga platformat më të ndjekura nga qytetarët (85.7%) dhe Regjistrin Elektronik (28.6%) si detyrim ligjor për publikimin e informacioneve që lidhen me procesin e njoftimit dhe konsultimit publik.



Ndërsa materialet informuese fletëpalosje (14.3%) është ndër format më pak të përdorura për informimin e qytetarëve dhe botimet e bashkisë të cilat nuk janë të përdorura. Të anketuarit janë pyetur për sfidat dhe vështirësitë që ndeshin në njoftimin dhe

informimin e publikut, ato kanë shprehur se komunikimi i drejtpërdrejtë me qytetarët është shumë i rëndësishëm dhe duhet të jetë gjithmonë i thjeshtë, i strukturuar dhe i kuptueshëm.

Aksesi i qytetarëve në dokumenta

Të anketurit janë pyetur mbi aksesin që kanë qytetarët për të marrë dokumenta apo informacione të ndryshme dhe në masën 100% ato janë përgjigjitur se në Bashkinë Pukë informacioni për qytetarët është lehtësisht i aksesueshëm. Tek Zyrat me Një Ndalesë dhe koordinatori për të drejtën për informim iu mundëson qytetarëve për tu njohur me informacionin publik brenda afateve dhe kushteve të përcaktuara me ligj. Institucioni po ashtu e ka për detyrë të prodhojë dhe të publikojë informacion i cili është i thjeshtë dhe i kuptueshëm për qytetarin.




Publikimi i akteve në faqen zyrtare





Në faqen zyrtare ëeb të Bashkisë në menunë Regjistri i Akteve janë të publikuara të gjitha aktet e miratuara nga Këshilli Bashkiak. Të intervistuarit pohojnë në masën 100% se realizohet publikimi i akteve në faqen zyrtare si dhe afishimi i tyre në vende të caktuara për çështje të ndryshme.


Programi i Transparencës



Ligji 119/2014 për Veteqeverisjen Vendore detyron autoritetet publike për të përgatitur, publikuar dhe përditësuar programin e transparencës duke synuar rritjen e aksesit në informacione zyrtare. Program Transparencë quhet dokumenti që përmbledh tërësinë e informacioneve që duhet të jepen në mënyrë aktive nga bashkia pa kërkesë. Programi i Transparencës publikohet në faqen zyrtare të internetit të bashkisë në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” në vendet e caktuara për njoftimet publike të bashkisë dhe njësive administrative.



Të intervistuarit u shprehën në masën 85.7% se Bashkia harton dhe publikon Programin e Transparencës si dhe raportet vjetore për transparencën, ndërsa një i intervistuar u shpreh që nuk e di. Nga monitorimi i kryer Programi i Transparencës si dhe raportet vjetore për transparencën në vendimarrje janë të publikuara në faqen zyrtare dhe mund të aksesohen.



Anketuesit pohojnë se Programi i Transparencës përfshin numrin e akteve të miratuara nga Bashkia përgjatë vitit, numrin e përgjithshëm të rekomandimeve të marra nga palët e interesuara, numrin e rekomandimeve e të komentëve të pranuar dhe të refuzuara gjatë procesit të

vendimmarrjes si dhe numrin e takimeve publike të organizuara.

Sfidat dhe Vështirësitë

Pyetjes se cilat janë disa nga sfidat dhe vështirësitë që keni ndeshur për njoftimin dhe informimin e publikut të intervistuarit nga Bashkia u përgjigjen si

- Marrja e informacionit
- pamundësia e përdorimit të internetit dhe mjeteve digjitale
- indiferentizmi
- mungesa e medias lokale si mundësi informimi e një target grupi që mund t'i referohej medias lokale më lehtë se informacionit apo rrjeteve online
- hapësira e madhe gjeografike
- thjeshtëzimi i informacionit të përshtatshëm për çdo grup shoqëror apo nivel social.

Përsa i përket pyetjes sesi mund të përmirësohej më tej zbatimi i këtij procesi në të ardhmen, punonjësit e Bashkisë rekomandojnë:

- të rritet ndërgjegjesimi i qytetarëve
- të bëhet paisja sa më efikase me teknologji dhe IT
- të ketë publikime dhe konsultime më të shpeshta mbi të drejtën për t'u informuar

Trajnimet mbi detyrimet ligjore mbi informimin publik



Të intervistuarit janë pyetur nëse kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore për informimin e publikut, ku 57 % janë përgjigjur se kanë zhvilluar trajnime të tilla dhe 43% që jo. Po ashtu, ato janë shprehur se ka gjithmonë nevojë për të tilla trajnime si për

qytetarët ashtu dhe për nëpunësit. Njohja më e mirë e ligjit nga ana e tyre do sillte përmirësime dhe kualitet në mënyrën e kuptimit dhe informimit adekuat.

Të pyetur për nevojat për trajnime në të ardhmen në lidhje me informimin publik, njoftimin dhe konsultimin ata u shprehën për trajnime specifike në lidhje me konsultimin publik dhe njohje me të gjithë ecurinë e procesi. Dikush u shpreh se ka nevojë për trajnime të herë pasë herëshme për cdo nënpunës të administratës.

GJETJET NGA ANKETIMET ME PËRFAQËSUES TË KËSHILLIT BASHKIAK

Në anketim janë përfshirë 5 anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe Sekretarja e kb. Informacionin dhe gjetjet e anketave po i paqesim sipas grafikës dhe informacionit të mëposhtëm:

Njoftimi, Informimi dhe Konsultimi Publik në Nivel Vendor

Të intervistuarit e Këshillit Bashkiak Pukë e vlerësojnë në masën 66.7 % shumë rëndësinë e njoftimit dhe informimit në vendimmarrjen vendore, 33.3 % i rëndësishëm. Njoftimi i publikut për mbledhjet e këshillit realizohet në forma të ndryshme duke e shikuar si një element shumë të rëndësishëm pjesëmarrjen e qytetarëve në procese të ndryshme konsultuese.




Mbledhjet e Këshillit Bashkiak janë një proces shumë i rëndësishëm sa i përket konsultimit publik në vendimmarrjen vendore. Pjesëmarrja qytetare është një e drejtë e qytetareve në kuadër të qeverisjes, prandaj për të pasur një proces efektiv konsultimi publik duhet të ketë pjesëmarrje.



Kuadri Ligjor për Njoftimin, Informimin dhe Konsultimin Publik



Shumica e të intervistuarve janë shprehur se e njohin mirë bazën ligjore për njoftimin, informimin dhe konsultimin në vendimmarrjen vendore. Vihet re se këshilli Bashkiak ka një rregullore të mirëfilltë për realizimin e procesit të njoftimit dhe konsultimit.




Duke qenë se kuadri ligjor përbën edhe bazën e punës së tyre, është e rëndësishme që ai të jetë edhe i qartë dhe i plotë për të përmbushur misionin e vetë. 50 % e anëtarëve të Këshillit Bashkiak të intervistuar e vlerësojnë kuadrin ligjor si të qartë dhe të plotë, ndërsa rreth 50 % e vlerësojnë si i qartë por jo i plotë.

Rregulloret e Këshillit Bashkiak

Shumica e pjesëmarrësve në pyetsorë i vlerësojnë rregulloret e Këshillit Bashkiak si të qarta dhe të plota, ndërsa pjesa tjetër si të qarta dhe jo të plota.

Gjithashtu, ato janë pyetur nëse do kishte nevoja për rishikime apo plotësime cilat do të ishin rekomandimet, u shprehën se informacioni duhet të jetë më i thjeshtë në terma për qytetarët si dhe iniciativat qytetare duhet të jenë më transparente dhe duhet të ketë më shumë bashkëpunime. Të pyetur për ekzistencën e rregulloreve dhe procedurave të brendshme të Këshillit Bashkiak të miratuara për realizimin e procesit njoftimit dhe informimit, anëtarët e KB janë përgjigjur se cdo shpallje bëhet në faqjen zyrtare të Bashkise. Gjithashtu vendimet shpallen për njoftimin e publikut dhe se ka një VKB nr. 14 date 30.06.2020, "Rregullore e funksionimit të Këshillit Bashkiak Pukë". Pyetjes nëse mendoni që ka nevojë për rishikim apo plotësime, cilat do të ishin rekomandimet tuaja këshilltarët ju përgjigjen se duhet vepruar më të hapur me publikun dhe duke u këshilluar me të.



Bashkëpunimi Bashkisë dhe Këshillit Bashkiak Pukë

Përsa i përket bashkëpunimit mes Këshillit Bashkiak dhe Bashkisë Pukë për procesin e njoftimit dhe informimit me publikun të intervistuarit i janë përgjigjur se ekziston në masën 100%. Shembulli më i mirë që ato japin janë zhvillimi i përbashkët i dëgjesave



publike që janë realizuar për përcaktimin e taksës lokale dhe në kuadër të hartimit të buxhetit 2022 si dhe PBA 2022-2024. Ky bashkëpunim realizohet nëpërmjet mënyrave të ndryshme të komunikimit duke nisur me sektorin e IT-së për publikimin e njoftimeve dhe vendimeve, nëpërmjet njoftimeve mediatike, këndeve të njoftimit, si dhe asistencë për transmetimin e mbledhjeve online.


Publikimi i Njoftimeve për Mbledhje

Nga monitorimet e kryera vihet re se Këshilli Bashkiak Pukë njofton për mbledhjet 5 ditë para zhvillimit të tyre. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara për këtë qëllim brenda territorit të njësisë vendore dhe përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes. Të intervistuarit po ashtu kanë pohuar se ky rregull zbatohet plotësisht.



Publikimi i akteve


Neni 18 i Ligjit 139/2015 referon në mënyrë të drejtpërdrejtë Ligjin 119/2014 teksa përcakton shprehimisht se: “Aktet e këshillit publikohen në faqen zyrtare të internetit dhe afishohen në vende publike, të caktuara nga këshilli me akses të lirë publik, brenda territorit të njësisë vendore dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre.”.



Nga monitorimet e kryera në faqen ëeb të Bashkisë Pukë janë të publikuara të gjitha Vendimet e Këshillit Bashkiak. Po ashtu, të gjithë të anketuarit e kanë pohuar këtë, ndërsa për publikimin e akteve në vende me akses të lirë publik kanë votuar në masën 50%, duke qenë se mund të publikohen vetëm akte të caktuara.


Njoftimi dhe Informimi i Publikut

Këshilli Bashkiak Pukë ka të gjitha burimet e nevojshme për realizimin e njoftimit dhe informimit për publikun. Njoftimi dhe informimi i publikut realizohet sipas formave të ndryshme të komunikimit duke përfshirë këtu mediat sociale apo takimet e drejtpërdrejta me qytetarët.




Regjistri Elektronik

1/3 e të intervistuarve nga KB janë në dijeni të ekzistencës së Regjistrimit Elektronik dhe që është i publikuar në faqen ëeb të Bashkisë. Pjesa tjetër që përbën edhe shumicën dërmuese ose nuk është në dijeni të këtij regjistri ose shprehen që nuk ka





një të tillë. Ndërkohë nga monitorimi i faqes vërehet që ky regjistër ekziston, madje edhe për mbledhjet e KB.




Programi i Transparencës

Anëtarët e keshillit Bashkiak janë pyetur nëse janë në dijeni për publikimin e Programit të Transparencës nga Bashkia Pukë dhe në masën 100% ato janë përgjigjur po. Po ashtu, janë pyetur në lidhje me publikimin e raporteve vjetore për transparencën në procesin e vendimmarrjes. 66.7 % e tyre janë shprehur se Këshilli Bashkiak publikon raporte të tilla, ndërsa 33.3 % kanë thënë jo ose nuk përditësohen. Programet e Transparencës ndërtohen dhe publikohen vetëm nga Bashkia Pukë dhe jo nga Këshilli Bashkiak.



Rritje Kapacitetesh Përmes Trajnimeve

Për pyetjen a kanë marrë trajnime në lidhje me detyrimet ligjore dhe informimin publik të gjithë janë përgjigjur se Po kanë marrë. Sipas tyre, trajnimet janë të nevojshme për një performim më të mirë në lidhje me informimin publik duke mësuar më shumë mbi praktikat dhe procedurat e sakta në kryerjen e detyrës. Por, u shprehën se gjithmonë ka nevoja për trajnime të ndryshme, si psh: si realizohet shpërndarja e fondeve sipas nevojave me publikun në një konsultim të gjërë apo si realizohen proceset e informimit, konsultimit dhe njoftimit publik.



KONKLUSIONE

- Procesi i njoftimit, informimit dhe konsultimit publik vlerësohet nga institucioni i Bashkisë Pukë dhe Këshillit Bashkiak si një proces shumë i rëndësishëm dhe shumë i nevojshëm me qëllim që të kontribuojë në rritje të transparencës dhe të rrisë pjesëmarrjen e qytetarëve në procese të ndryshme të vendimarrjes.
- Sektorët kryesorë në bashki ndihmojnë në informimin e publikut, marrëdhëniet me publikun dhe të drejtën e informimit, punonjësit nuk e neglizhojnë asnjë ankesë apo kërkesë të qytetarëve ndaj bashkisë.
- Bashkia Pukë zhvillon komunikimet publike me qytetarët në mënyrë të drejtpërdrejtë përmes takimeve periodike me grupe qytetare apo me grafik takimesh me banorë të katër njësive administrative dhe me anë të medias kryesisht sociale apo ëeb faqe, përdor këndin e njoftimeve të publikut etj.
- Pavarësisht se Këshilli Bashkiak i zhvillon mbledhjet e hapura, interesi qytetar për të marr pjesë është i ulët. Me mbështetjen e projektit për Bashki të Forta është mundësuar ndjekja online e mbledhjeve dhe është vlerësuar pozitivisht, pasi nga mbledhja në mbledhje vërehet numër i shtuar ndjekësish.

REKOMANDIME

- Realizimi i procesit të konsultimit publik ka nevojë të thellë për përmirësime, pasi duhet të nxiten qytetarët të marrin pjesë sa më shumë në diskutime publike dhe jo vetëm të ftuar apo punonjës të administratës. Duhet gjetur mënyra që tërheqin publikun dhe qytetarët për të qenë sa më të përfshirë në proceset e vendimarrjes.
- Bashkia duhet të përditësojë sa më shumë kanalet e saj të informimit dhe komunikimit me qytetarët dhe format e shpërndarjes së informacionit duhet të jenë edhe në kuadër të të dhënave dhe jo vetëm si reklamim i punëve që bën bashkia.
- Në bazë të ligjit 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit” çdo autoritet shtetëror duhet të ketë faqen e internetit ku duhet të publikojë një sërë informacionesh.
- Procesi i dixhitalizimit të shumë shërbimeve edhe pse vlerësohet si pozitiv në marrjen e shërbimeve të shpejta e pa shpenzime për një pjesë të përdoruesve, është kthyer në një problem për një pjesë tjetër të konsiderueshme kryesisht zonat rurale, ku nuk ju ofrohet as linjat e internetit por as mjetet dixhitale për të pas mundësi në përfitimin e këtyre shërbimeve. Ndryshimi kaq i shpejtë dhe mosmarrja parasysh e këtyre problemeve për një kategori njerëzish nuk është pritur pozitivisht. Bashkia duhet të mbështesë qytetarët duke ju ofruar asistencë ose të ngrejë zërin për ta që për një periudhë të caktuar të shërbehet edhe online edhe fizikisht - deri sa zyrat dhe punonjësit janë aty qytetari ka të drejtën e vetë ta pranojë shërbimin si e ka vetë më të lehtë.

Rrjeti “Përballja e Ofertave Politike – POP”, synon të rrisë debatin publik dhe informacionin te qytetarët si dhe orientimin e platformave drejt nevojave dhe prioriteteve të tyre. Përmes aktiviteteve projekti synon të forcojë demokracinë shqiptare, duke nxitur transparencën dhe llogaridhënien. Përballja e Ofertave Politike - POP, është një nismë e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile shqiptare mbështetur nga “Olof Palme International Center” dhe “National Endowment for Democracy.” Anëtarët e Rrjetit POP janë organizatat si më poshtë:

- Qendra “Aleanca Gjimore për Zhvillim”, Tiranë;
- Qendra për Zhvillimin e Shoqërisë Civile, Durrës;
- Qendra Rinore Vlorë,
- Shoqata për Integrimin e Zonave Informale, Kamëz;
- Epoka e Re, Fier;
- Intelktualët e Rinj Shpresë, Shkodër;
- Lëvizja Rinore për Demokraci, Pukë;
- Qendra Rinore për Progres, Kukës,
- Rinia për Integrim, Aktivizim dhe Sensibilizim, Progradec;
- Gruaja në Zhvillim, Korçë;
- Hapa të Lehtë, Vau i Dejës;
- Tjetër Vizion, Elbasan